

SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës  
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-76/13

Prishtinë,

29 janar 2014

Në çështjen juridike të

**Sh. B.**

Prizren

*Pala ankuese*

kundër

**L. R.**

Prizren

*Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/167/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA11706), të datës 5 shtator 2012 pas shqyrtimit të mbajtur më 29 janar 2014, mori këtë

## JUDGMENT

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Sh. B.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/167/2012 (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA11706), të datës 5 shtator 2012.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 24 prill 2007, Sh. B. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) ku ka kërkuar të drejtën e shfrytëzimit të një banese me sipërfaqe prej 51,87 m<sup>2</sup> në rrugën Eduard Kardeli (Adem Jashari) 5 28 në Prizren. Berisha më vonë ka dorëzuar në AKP një certifikatë të Prokurorit Publik të Qarkut kur ceket se Berisha kishte jetuar në këtë banesë nga 1 janari 1973 deri në shtator të vitit 1982.
2. L. R. është përgjigjur në kërkesë më 6 prill 2009. Në përgjigje, ai ka deklaruar se banesa ishte blerë nga babi i tij A. R. më 2 shkurt 2006. A.R. tani është i vdekur dhe banesa shfrytëzohet nga trashëgimtarët e tij, vetë L.R dhe vëllai i tij K. R..
3. Më 5 shtator 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) e ka hedhur poshtë kërkesën me vendimin grupor. Në paragrafin 32 të vendimit grupor ceket se kërkesa është jashtë juridiksionit të KKPK-së, sepse vetë paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se e kishte humbur posedimin e pronës në vitin 1982.
4. Vendimi i ishte dorëzuar B. më 27 shkurt 2013. Ai ka paraqitur anekse në Kolegjin e Apelit të Gjykatës Supreme më 11 mars 2013. Ankesa i ishte dorëzuar R. më 3 qershor 2013. Ai nuk është përgjigjur brenda afatit prej 30 ditësh. Gjykata Supreme e ka pranuar lëndën më 15 janar 2013.

### Pretendimet e palëve

5. Sh.B. pretendon se vendimi bazohet në vlerësimin e gabuar dhe jo të plotë të provave.

6. Nuk është kontestuese se B. ishte bartës i së drejtë së banimit të banesës kontestuese dhe se ai kishte banuar në atë banesë për 10 vite. Atij i ishte ndarë banesa nga organet shtetërore të asaj kohe, së pari si gjyqtar i Gjykatës Komunale në Prizren e pastaj si prokuror. Banesa ishte pronë e Kuvendit Komunal të Prizrenit. Shitjet pasuese që janë bërë nga fabrika “Progres” në Prizren, në rastin e fundit tek A. R., nuk mund të prodhojnë ndonjë efekt juridik.
7. L. R. nuk është përgjigjur në ankesë, por ai ka pohuar para KKPK-së se babai i tij kishte bërë blerjen e ligjshme të banesës.

### **Arsyetim ligjor**

8. Ankesa është pranueshme pasi që ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).
9. Vetë B. ka deklaruar se e kishte humbur pronësinë e banesës në vitin 1982 pasi që kishte jetuar në të për 10 vite.
10. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë pronën Bujqësore dhe atë Komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë që të zgjidh kërkesat pronësore dhe kërkesat për të drejtën pronësor që “drejtpërsëdrejti ndërlidhen me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.”
11. Është e qartë se kërkesa e B. në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet me konfliktin e viteve 1998-1999. Prandaj, Gjykata Supreme pajtohet me vendimin e KKPK-së se kërkesa ishte jashtë juridiksionit të tij dhe si e tillë është dashur të hedhet poshtë. Anesa është e pabazuar dhe Gjykata Supreme e ka konfirmuar vendimin e KKPK-së.
12. Prandaj, rrjedhimisht mbi të mësipërmen sipas dispozitës së nenit nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Udhëzim juridik**

13. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

*Elka Filcheva - Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX*

*Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it*

*Sylejman Nuredini, Gjyqtar*

*Holger Engelmann, Referent i EULEX- it*